



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

Komente nga anëtarë e bashkëpunëtorë të Këshillit të Investimeve



SEKRETARIATI I KËSHILLIT TË INVESTIMEVE
SHQIPËRI

2022

KËSHILLI I INVESTIMEVE është një platformë e ngritur nga autoritetet shqiptare me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), me synim intensifikimin e dialogut mes qeverisë dhe sektorit privat, përmirësimin e klimës së biznesit dhe promovimin e mirë qeverisjes. Platforma mbështetet nga Sekretariati i përbërë nga një grup i pavarur profesionistësh të zgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërdrejtë me komunitetin e biznesit. Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO)

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Stafi

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)
Drejtores e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva
Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al


Elida Fara
Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha
Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula
Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

[f](#) Albania Investment Council [AIInvestCouncil](#) [in](#) Albania Investment Council



Sekretariati i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).

KOMENTE NGA ANËTARË E BASHKËPUNËTORË TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

2022

Materiali është përgatitur nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve, znj. Xaira Shurdha, Eksperte e Ndërlidhjes dhe Monitorimit nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni) me mbështetjen e z. Elvis Zerva, Ekspert Ligjor e Rregullator dhe znj. Elida Fara, Eksperte Ekonomie. Përgatitja e dizajnit u koordinua nga znj. Elisa Lula, Specialiste e komunikimit pranë Sekretariatit. Informacioni i përmbledhur në këtë raport është përpiluar bazuar në komentet e bashkëpunëtorëve të Këshillit të Investimeve të kontaktuar përmes një pyetësi online, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e BERZH-it apo SECO-s. Materiali (tekst apo imazh), nuk mund të përdoret për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të specifikuar në të.

Informacioni i përmbledhur në këtë raport është përpiluar bazuar në komentet e bashkëpunëtorëve të Këshillit të Investimeve të kontaktuar përmes një pyetësi online, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e BERZH-it apo SECO-s. Materiali (tekst apo imazh), nuk mund të përdoret për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të specifikuar në të.

KOMENTE NGA ANËTARË E BASHKËPUNËTORË TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

2022

SHKURTIME


BERZH/EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KI	Këshilli i Investimeve
SKI	Sekretariati i Këshillit të Investimeve
MFE	Ministria e Financës dhe Ekonomisë
SECO	Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike
EU	Bashkimi Evropian
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MSHMS	Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
DIHA	Dhoma Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri
AMCHAM	Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri
FIAA	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri
AMA	Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

PËRMBAJTJA

01	Mesazhe Kryesore	F. 06-07
02	Konteksti	F. 08-10
03	Formati & Organizimi i KI si një kanal efektiv dialogu	F. 11-17
04	3 pikat më të forta të KI	F. 18-19
05	Përfshirja e komunitetit të biznesit dhe e Institucioneve publike	F. 20-21
06	Vizibiliteti i KI	F. 22-23
07	Ndikimi i KI në Klimën e Investimeve	F. 24-25
08	Eksperienca personale dhe profesionale me KI	F. 26-27
09	Qëndrueshmëria e platformës së KI	F. 28
10	Vijueshmëria e bashkëpunimit me KI/anëtarët e KI	F. 29
11	Shtojca 1 – Pyetësori drejtuar anëtarëve e bashkëpunëtorëve të KI	F. 30

01

Mesazhe Kryesore



Përmeshja e misionit të Këshillit të Investimeve, ndërlidhet ngushtë me përfshirjen aktive jo vetëm të anëtarëve të tij, por edhe me angazhimin e shumë bashkëpunëtorëve që operojnë në sfera të ndryshme, si sipërmarrës të disa sektorëve, ekspertë të fushave ligjore, financiare, të teknologjisë së informacionit apo edhe sektoriale, institucione publike, universitete, institucione kërkimore, shoqëri civile e media.

Përmes vlerësimit të këtij viti nga anëtarët e bashkëpunëtorët, u përcollën disa mesazhe kryesore:


- Evidentohet interes në rritje i disa aktorëve të biznesit për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në platformën KI. Numri i anëtarëve është vlerësuar me Shumë mirë nga 62% e të anketuarve dhe është shoqëruar me komente **për zgjerim numri dhe përbërje. Në këtë drejtim, ka sugjerime për shtrirje më të gjerë gjeografike dhe sektoriale të anëtarëve të KI.**
- Më shumë se 70% vlerësojnë me shumë mirë (në të tre dimensionet¹), temat e trajtuara në KI. **Evidentohet konvergencë me vlerësimin e vitit 2021, ku votimi**

dhe përzgjedhja e temave të agjendës së KI mori pikët maksimale. Si risi këtë vit, agjenda e vitit 2022 iu dërgua për votim anëtarëve aktualë por edhe atyre të mëparshëm (2015-2021) dhe u vu re një angazhimi maksimal i tyre në proces.

- **Qartësia e informacionit dhe saktësia e të dhënave të materialeve analitike të paraqitura në Këshillin e Investimeve ri konfirmohen edhe këtë vit si kategoritë më pozitive të vlerësimit të këtij indikator.**
- **Përmirësim i treguesit “Avokimi mbi nxitjen e aktorëve me influencë drejt përmbushjes së rekomandimeve” krahasuar me vitin e kaluar (vlerësuar nga 62% e anëtarëve të intervistuar si Shumë Mirë dhe Shkëlqyeshëm).** Kjo është në koherencë me standardizimin e procesit të monitorimit nga KI, por edhe në sajë të një angazhimi më të fokusuar nga ana e MFE gjatë 2022.
- Një veçanti nga vlerësimi aktual, **është se mbi 71% e të anketuarve vlerësojnë me shumë mirë treguesin “Avokimi i punës së KI në takimet e organizuara nga aktorë të tjerë”.** Kjo lidhet kryesisht me konsolidimin e reputacionit dhe seriozitetit të platformës ndër vite, dhe do të ketë vëmendje të mëtejshme në vitin 2023, veçanërisht në angazhimin e anëtarëve të KI në avokimin e KI.
- Vihet re ndërgjegjësim i partnerëve të KI mbi cilësinë së përfshirjes së agjencive/institucioneve publike në KI. **Këtë vit, rreth 19% e të anketuarve vlerësojnë se duhet përmirësuar shpejtësia e reagimit për përmbushjen e rekomandimeve.**
- Ndër materialet e prodhuara dhe të publikuara nga sekretariati i KI, interesi dhe vlerësimi kryesor gjatë këtij viti është mbi **«Gjetjet e anketave», «Notat teknike», «Raportet e monitorimit» dhe «Përmbledhjet e treguesve makroekonomikë».**

1 Përzgjedhja e Tematikave (2) Procesi i votimit të temave (3) Miratimi përfundimtar i axhendës.

02 Konteksti



Gjatë vitit 2022, Këshilli i Investimeve ka organizuar tre mbledhje plenare, duke përfshirë në çdo mbledhje pothuajse të gjithë anëtarët e tij². Përfaqësues të komunitetit të biznesit janë 7 shoqata dhe 2 kompani private (add-hoc) që kontribuojnë në a) prioritizimin e çështjeve kryesore dhe hartimin e agjendës së KI-së, b) konsultimet, c) anketat vjetore si dhe c) propozimin e rekomandimeve konkrete mbi problematika të klimës së investimeve. Puna dhe procesi i përmirësimit të vazhdueshëm të KI-së, mbështetet në procesin e vlerësimit të ofruar nga anëtarët dhe bashkëpunëtorët e tij, që nga viti 2016³. Procesi i mbledhjes së komenteve, ka pësuar ndryshime nga viti në vit duke:

- (1) zgjeruar gamën e pyetjeve dhe nivelin e detajimit të tyre, në koherencë me shtyllat kryesore të punës së KI, për të mundësuar një analizë më të thelluar,
- (2) lehtësuar aksesin në proces duke përcjellë pyetjet në formatin e anketimit online, anonim me synim plotësimin e tij si nga telefoni, ashtu edhe nga kompjuteri dhe në një kohë të përshtatshme për të anketuarit
- (3) zgjeruar numrin e të kontaktuarve jo vetëm me anëtarë që largohen nga KI⁴, por edhe bashkëpunëtorë e partnerë që ndërvepruan me KI për tematika të ndryshme duke përcjelle komentet e tyre mbi cilësinë e punës së Këshillit të Investimeve, metodologjinë, formatin e përbërjen e KI, eksperiencën personale me KI, vizibilitetin dhe influencën

2 18 anëtarë


3 Për raporte të mëparshme, kliko linkun <https://www.investment.com.al/sq/komente-nga-anetaret-e-ki/>

4 Praktikuar deri në 2019

në dialogun mbi klimën e investimeve në vend si edhe në sugjerime për përmirësime të mëtejshme të punës.

Në përputhje me këtë metodologji dhe standardin e punës së KI, gjatë periudhës Nëntor-Dhjetor 2022, u kontaktuan 48 anëtarë e bashkëpunëtorë të KI nga të cilët, 21 e plotësuan atë:

Figurë 1. Përbërja e të anketuarve



Duke vlerësuar maksimalisht angazhimin e të intervistuarve për të ofruar pikëpamjet e tyre mbi pyetjet e detajuara (sidomos ato narrative), veçojmë më poshtë disa nga **komentet e tyre më relevante**:

- » KI ndikon në përmirësimin e dialogut mbi klimën e investimeve në drejtim të nxitjes së institucioneve publike apo partnerëve për zhvillim, për reagim ndaj kërkesave të biznesit dhe për përmbushjen e rekomandimeve të KI. Gjithashtu ka ndikim në kuadrin rregullator, **në rritje ndërgjegjësimit** dhe përmirësimin e konsultimit.
- » KI është një format që ka rezistuar në kohë, duke ofruar transparencë dhe përfaqësim të balancuar publik-privat, ndaj duhet konsideruar si një platformë afatgjatë dialogu e me interes për biznesin që duhet të vijojë të funksionojë më të njëjtin format.
- » Përmes prezantimit të materialeve analitike tek anëtarët e KI, paraqitet ekspertizë mjaft profesionale nga ekipi i sekretariatit.
- » Tematikat e trajtuara në KI janë mjaft aktuale dhe me ndikim në politik bërjen që lidhet me klimën e biznesit dhe investimeve.

- » Harmonizimi i punës midis Institucioneve Shtetërore është një çështje që shfaq probleme, dhe kjo ndikon në përmbushjen finale të misionit të KI. Reagimi për përmbushjen e rekomandimeve nga ana e KI vlerësohet shumë mirë, por jo çdo gjë varet nga KI⁵.
- » KI është një strukturë, ku pjesëmarrësit vlerësojnë mundësinë e avokimit publik në presencë të aktorëve me influencë, rrjetëzimit e dialogimit.

Gjithashtu çmujmë edhe **sugjerimet e dhëna në drejtim të përmirësimit të punës** së KI:

- » Agjencitë/institucionet publike duhet të marrin më seriozisht shqyrtimin dhe ndjekjen e problematikave dhe rekomandimeve të dala nga mbledhjet e KI. Gjithashtu është thelbësore që institucionet qeveritare të përmirësojnë nivelin e angazhimit të tyre në dialog.
- » Sugjerohet të ftohen si anëtarë edhe ekspertë aktivë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë që do ndikonin në përmirësimin e cilësisë së debatit.
- » Të mbahet në konsideratë që diskutimet duhet të jenë të fokusuar e jo shumë të gjata, gjithashtu me rëndësi është të bëhen të ditura në mbledhje hapat konkrete që do merren në vijim të diskutimit.
- » KI duhet të afrohet me akademinë dhe ekspertët e politikave ekonomike, në funksion të përmirësimit të metodikës së analizave dhe përfshirjes së "Peer Reviewers", instalimit pranë KI të metodave të standartizuara të analizave dhe parashikimeve të cilat forcojnë avokimin për rekomandimet duke përfshirë impaktin e pritshëm të tyre.
- » Me mjaft rëndësi do ishte vlerësimi i impaktit të ndryshimeve e politikave të reja rregullatorë, tek biznesi.

Ndërkohë, referuar komenteve nga raportet e viteve të mëparshme, theksojmë që disa nga sugjerimet e dhëna janë marrë tashmë parasysh nga Sekretariati i KI dhe anëtarët e KI gjatë vitit 2022, konkretisht :

- » **Të konsiderohet përfshirja si anëtarë e më shumë përfaqësuesve gra** - numri i grave pjesëmarrëse është rritur duke përfshirë për herë të parë si anëtare edhe Dhomen Ekonomike të Gruas. Për më tepër, përbërja gjinore e anëtarësisë është integruar në të gjitha anketimet e iniciuara nga Sekretariati.
- » **Ri sjellja në vëmendje gjatë mbledhjeve të KI, të disa tematikave/çështjeve të trajtuara në mbledhjet e mëparshme por akoma të paplotësuara** nga institucionet përgjegjëse. Ky sugjerim është marrë në konsideratë duke përfshirë rekomandimet e paplotësuara nga mbledhjet e mëparshme, në seksione specifike të materialeve analitike të prezantuara gjatë mbledhjeve, si dhe në raportimet për ecurinë e rekomandimeve të KI.

Në seksionet e mëposhtme sjellim në mënyrë të detajuar pikëpamjet dhe sugjerimet e bashkëpunëtorëve sipas komponentëve kryesorë të trajtuar:

5 Koment nga anëtarët

03

Formati & Organizimi i KI si një kanal efektiv dialogu


Nën këtë komponent, të intervistuarit shprehën opinionin e tyre mbi (1) Anëtarësinë e KI, (2) Axhendën /Tematikave të trajtuara nga KI, (3) Metodologjinë e punës, (4) Cilësinë e materialeve analitike, (5) Rekomandimet, (6) Avokimi i çështjeve të trajtuara /Ndjekja e diskutimeve, dhe (7) Procesi i raportimit tek Anëtarët e KI.

Metoda e vlerësimit të pikave të mësipërme u bë përmes përzgjedhjes së pesë opsioneve: Duhet përmirësuar; Mirë; Kënaqshëm; Shumë mirë; Shkëlqyeshëm, dhe vetëm në rastin e përzgjedhjes së opsionit Duhet Përmirësuar, të intervistuarit kishin mundësinë të shprehnin komente specifike.

3.1 ANËTARËSIA E KI


Ky komponent u vlerësua bazuar në indikatorët (1) Numri i anëtarëve (2) Përbërja e anëtarësisë (3) Balancimi publik- privat, ku shumica e të anketuarve mbi 53% dhanë vlerësimin Shumë mirë për të tre këto indikatorë.

Figurë 2. Vlerësimi i Anëtarësisë së KI



Më specifikisht, komentet e dhëna nga 33% e të anketuarve të cilët kanë vlerësuar që ka nevojë për përmirësim në këtë drejtim, lidhen me sugjerimet mbi zgjerimin e anëtarësisë.

Figurë 3. Zgjerimi i Anëtarësisë së KI



Është sugjeruar që si anëtarë të mundshëm permanentë, mund të konsideroheshin:

- » Aktorë të tregut financiar Shoqata Mikrofinanca Shqiptare
- » Konsulentë aktivë në sektorë të ndryshëm të Ekonomisë
- » Përfaqësues të Institucioneve të Arsimit Profesional
- » Përfaqësues nga ekosistemi i startup-eve⁶.


6 Ky është një sugjerim edhe i vitit të kaluar

Për më tepër është komentuar edhe që “Referuar përfshirjes së anëtarëve, vërejmë që Këshilli ka si anëtarë përfaqësues të shoqatave të huaja, por që disa prej tyre nuk përfaqësojnë në mënyrë të konsiderueshme bizneset si në numër e as në peshë në ekonomi, ndërkohë janë disa shoqata vendase me peshë e numër që konsiderohen si të ftuar, jo anëtarë”.

3.2 Tematikat e trajtuara në Këshillin e Investimeve

Mbi 75% e të anketuarve, kanë vlerësuar me Shumë mirë, këtë komponent duke iu referuar tre indikatorëve: (1) Përzgjedhja e Tematikave (2) Procesi i votimit të temave (3) Miratimi përfundimtar i axhendës.

Figurë 4. Tematikat e trajtuara në KI




Të anketuarit që gjykojnë se ka nevojë për përmirësim, komentojnë se tematikat mund të jenë më të fokusuar në disa raste.

3.3 Frekuenca e mbledhjeve të Këshillit të Investimeve

- » Nga 71% e të anketuarve, vlerësohet frekuenca aktuale e mbledhjeve të KI si Shumë e mirë dhe 19% e tyre si Kënaqshëm. Nga të intervistuarit që konsiderojnë se ka vend për përmirësim, u referua komenti “Frekuenca e mbledhjeve duke parë problematikat e shumta, ndoshta edhe pa prezencën e vetë Ministres (pra në nivel teknik, jo plenar) mund të jenë më të shpeshta, për (1) të ndarë informacion problematikash të sektorëve që janë shumë dinamike, (2) për të dhënë nga ju informacioni në çfarë pike janë ato detyra që janë marrë parasysh për tu realizuar si dhe (3) për të dhënë presionin e nevojshëm problematikave që kërkojnë zgjidhje emergjente.

Figurë 5. Frekuenca e mbledhjeve të KI




3.4 Metodologjia e punës së Këshillit të Investimeve

Metodologjia e punës, u vlerësua përmes disa kategorive (1) Qasja nga poshtë-lart (2) Konsultime aktesh ligjore, ligje e projektligje (3) Përfshirja e anëtarëve (4) Survejimet periodike (5) Koha e shkëmbimit të njoftimeve (6) Diskutimet teknike në fokus grupe (7) Diskutimet nga anëtarët e të ftuarit në mbledhje (8) Aspekti operacional i organizimit.

Mbi 52% e të anketuarve i konsiderojnë Shumë Mire të gjithë indikatorët. Aspekti operacional i organizimit të mbledhjeve, është vlerësuar me Shumë mirë nga 86% e anketuarve, ndërkohë që niveli i angazhimit të anëtarëve ka vend për përmirësim.


Figurë 6. Metodologjia e punës së KI



3.5 Cilësia e materialeve analitike të paraqitura në Këshillin e Investimeve

Të tre kategoritë e përzgjedhura për vlerësimin e këtij komponenti, u vlerësuan kryesisht me Shumë Mire dhe Shkëlqyeshëm, ndërkohë që qartësia e informacionit dhe saktësia e të dhënave ri konfirmohen si indikatorët me pozitiv, sikurse shihet në grafikun më poshtë. Megjithatë, një nga të anketuarit, ka komentuar që “*materialet analitike të prezantuara, nuk janë mjaftueshëm të fokusuar referuar hapave të ardhshëm për tu zbatuar*”.

Figurë 7. Cilësia e materialeve analitike




3.6 Prezantimi i materialeve analitike në mbledhjet e KI përmes PPT përmbledhëse

Këtë vit u shtua një pyetje që lidhet me prezantimin që bëhet në fillim të çdo mbledhjeje nga përfaqësuesi i Sekretariatit të KI, duke reflektuar gjetjet kryesore dhe rekomandimet e evidentuara bazuar në punën analitike dhe takimet me sektorin privat. Kjo përmbledhje u përcillet anëtarëve brenda 10 minutave, duke u mundësuar bazën analitike me pikat kryesore që strukturojnë debatin mes përfaqësuesve të bizneseve dhe atyre të qeverisë.

95% e anëtarëve janë në favor të prezantimit paraprak dhe referuar pyetjes nëse përmbledhësja duhet ndryshuar, 43% e të anketuarve mendojnë se duhet diskutuar më gjatë dhe 29% e tyre mendojnë se duhet të jetë më e detajuar.

Figurë 8. Prezantimi i materialeve analitike




Një koment që është cilësuar në lidhje me përmbledhësen është që: “Përmbledhjet janë ndihmuese për marrjen e feedback në mbledhjet e keshillit. Koha e diskutimit dhe detajimi ngelen në varësi të temave të zgjedhura. Ato mund të përshtaten në varësi të temave dhe mund të mos jenë të paracaktuara në mënyrë të pandryshueshme. Gjithsesi, formati aktual ka qënë i mjaftueshëm.”

3.7 Rekomandimet e propozuara dhe miratuara në mbledhjet e KI

Mbi 71% e të anketuarve vlerësojnë Shumë mirë dhe Shkëlqyeshëm të gjithë kategoritë e konsideruara për vlerësimin e këtij komponenti (1) Cilësia (2) Përshtatshmëria (3) Koherenca (4) Llogaridhënia e Publikimeve.

Rreth 35% sugjerojnë për më shumë vëmendje në drejtim të përmirësimit të llogaridhënies dhe publikimit të rekomandimeve.

Figurë 9. Rekomandimet e propozuara dhe miratuara në mbledhjet e KI




3.8 Avokimi i çështjeve të trajtuara në KI

Në krahasim me vitin e kaluar, kategoria e avokimit mbi nxitjen e aktorëve me influencë drejt përbushjes së rekomandimeve, ka pasur përmirësim nga kënaqshëm në Shumë mirë, vlerësuar nga 62% e anëtarëve të intervistuar. Një koment që vlen të theksohet nga anëtarët, është evidentimi i faktit që përbushja e rekomandimeve është një aspekt i cili kërkon vendimarrje politike në më të shumtën e rasteve dhe angazhimin e shumë aktorëve, krahas përpjekjeve të bëra nga sekretariati i KI. Një fakt i tillë është sjellë në vëmendje edhe nga komentet e anketimit të viti të kaluar.

Referuar Avokimit në takime të organizuara nga aktorë të tjerë, 71% e të anketuarve e vlerësojnë gjithashtu me Shumë mirë.


Figurë 10. Avokimi i çështjeve të trajtuara në KI



3.9 Proçesi i raportimit tek Anëtarët e KI


Indikatorët e vlerësuar në këtë kategori, ishin (1) Përzgjedhja dhe njoftimi mbi ndryshime në KI (psh. Anëtarësia, etj) (2) Raportimi i progresit të rekomandimeve (3) Raporte vjetore (4) Buletinë informues periodikë dhe të gjithë janë vlerësuar nga mbi 48% e të anketuarve me Shumë mirë.

Figurë 11. Raportimit tek Anëtarët e KI



04


3 pikat më të forta të KI




Sikurse evidentuar në vitet e mëparshme, edhe këtë vit, dy pikat më të forta janë konsideruar “Puna aktive e sekretariatit, analizat dhe punën studimore të përcjellë përmes materialeve analitike” dhe “Gjithë-përfshirja, angazhimi, tërheqja e vëmendjes së përfaqësuesve kryesorë të qeverisë, bizneseve e donatorëve”.

Këtë vit, në dallim nga viti i kaluar si pikë e tretë dhe katërt vlerësuar nga 13% e anëtarëve, është konsideruar “Metodologjia e punës, ndjekja e çështjeve dhe insistimi në realizimin e objektivit;” dhe gjithashtu “Mbështetja e BERZH si një faktor i rëndësishëm paanshmërie, reputacioni dhe serioziteti”.

Figurë 12. 3 pikat më të forta të KI, 2022




Figurë 13. 3 pikat më të forta të KI, 2021



05

Përfshirja e komunitetit të biznesit dhe e Institucioneve publike



Nën këtë komponent të intervistuarit shprehën pikëpamjet e tyre mbi cilësinë e përfshirjes së komunitetit të biznesit dhe mbi përfshirjen e agjencive/institucioneve publike në KI.


Referuar komunitetit të biznesit, kategoritë e konsideruara për vlerësim të këtij indikatorit ishin:

1. Numri i përfaqësuesve në anëtarësinë e KI
2. Përbërja e anëtarësisë së biznesit - në nivel sektorial e shtrirje gjeografike
3. Përbërja e anëtarësisë nga pikëpamja gjinore
4. Kontributi i shoqatave të biznesit në dialog. Evidentojmë se shumica e të anketuarve, mbi 43% i kanë vlerësuar si Kënaqshëm këto kategori.

Referuar kontributit të shoqatave të biznesit në dialog, është komentuar:

- » “Anëtarët nga biznesi duhet të vinë më të përgatitur në mbledhje, me problematika më të qarta dhe propozime më cilësore dhe të reduktojnë diskutimet e gjata”.
- » “Niveli i përfaqësimit nga shoqatat e biznesit është shpesh herë një koleksion ndërhyrjesh pothuajse të rastësishme dhe kanë vlerë të shtuar të kufizuar”


Figurë 14. Përfshirja e komunitetit të biznesit



Mbi cilësinë e përfshirjes së agjencive/institucioneve qeveritare në KI u konsideruan pesë indikatorë nga të anketuarit:


1. Numri i përfaqësuesve në anëtarësinë e KI
2. Përbërja e anëtarëve dhe niveli i përfaqësimit
3. Përbërja e anëtarësisë nga pikëpamja gjinore
4. Kontributi në dialog në mbledhjet e KI
5. Shpejtësia e reagimit për përmbushjen e rekomandimeve. Përveç kategorisë “Përbërja e anëtarësisë nga pikëpamja gjinore” që është vlerësuar Shumë mirë nga 48% e anëtarëve, të gjithë kategoritë e tjera janë konsideruar kënaqshëm nga shumica e të anketuarve, sikurse shihet edhe në grafikun më poshtë:

Figurë 15. Përfshirja e institucioneve publike



06

Vizibiliteti i KI




Komponenti i vizibilitetit, që prej vitit të kaluar është zgjeruar me pyetje duke e parë si një kategori të rëndësishme për të rritur ndërgjegjësimin mbi punën e KI, influencën e tij dhe bërjen transparente të materialeve të prodhuara e të diskutuara në këtë platformë. Më konkretisht kategoritë e vlerësuara janë:

6.1 Niveli i njohjes së KI në nivel kombëtar nga komuniteti i biznesit

Mbi këtë pyetje, 52% e të anketuarve janë shprehur që KI njihet nga komuniteti i biznesit.

Figurë 16. Niveli i njohjes së KI në nivel kombëtar nga komuniteti i biznesit

A mendoni se Këshilli i Investimeve është i njohur mjaftueshëm në nivel kombëtar nga komuniteti i biznesit?



6.2 A mendoni se faqja e internetit e KI /profilet e KI në rrjetet sociale (FB/LN/ Twitter) japin informacion të mjaftueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm?


81% e të anketuarve vlerësojnë që KI jep informacion të mjaftueshëm përmes rrjeve sociale. Megjithatë, ka pasur edhe një koment mbi *nevojën për intensifikim të përdorimit*

të mediave sociale që përdoren nga komuniteti i biznesit (FB, LN dhe Instagram) dhe ndoshta edhe takime me biznesin jashtë Tiranës.

Evidentojmë që pas Covid - 19, edhe gjatë vitit 2022, janë organizuar konsultime me një shtrirje më të gjerë gjeografike e reflektuar edhe në materialet analitike të publikuara⁷.

Figurë 17. Niveli i informimit përmes rrjeteve sociale të KI

A mendoni se faqja e internetit e KI/profilet e KI në rrjetet sociale (FB/LN/ Twitter) japin informacion të mjaftueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm?




6.3 Informacionet më me interes për tu lexuar online

Ngaraporti i vitit 2021, citohet që tre materialet që kryesojnë, në interesin e bashkëpunëtorëve janë “Përmbledhjet periodike mbi treguesit makroekonomikë”, “Lajmet më të fundit” dhe “Raportet e monitorimeve mbi ecurinë e rekomandimeve”.

Ndërsa gjatë anketimit të 2022, evidentohen si dokumentat më me interes “Gjetjet e vrojtimeve” (24%), Notat teknike (19%), Raportet e Monitorimit mbi rekomandimet (13%) dhe Përmbledhjet e treguesve Makroekonomikë (13%).

Figurë 18. Informacionet më me interes për tu lexuar online


Informacionet që i keni më me interes të lexoni online, 2022



7 30 takime në rrethe jashtë Tiranës gjatë 2022 (me biznese e institucione publike)


07

Ndikimi i KI në Klimën e Investimeve



90% e të anketuarve vlerësojnë që KI ka ndikuar pozitivisht në klimën e investimeve në vend, duke cilësuar si fushat kryesore ku ka influencuar: (1) në nxitjen e institucioneve publike për reagim ndaj kërkesave të biznesit (2) në përmirësimin e konsultimit (3) në rritje ndërgjegjësimi (4) në kuadrin rregullator.

Figurë 19. Në çfarë drejtimi ka ndikuar KI në përmirësimin e dialogut ?




Si mund të matet më mirë influenca e punës së KI ndër vite dhe kontributi në përmirësimin e klimës së investimeve?

Komentet më të rëndësishme në lidhje me këtë pyetje, janë:

- » Raportet e monitorimit të aktivitetit të KI mund të shoqërohen edhe me vlerësim të impaktit të punës, një aspekt i vështirë por jo i pamundur tani që KI ka aktivitet për më shumë se 5 vite. Vlerësimi i impaktit në mid-term mund të shihej si element përforcues i monitorimit të aktiviteteve.
- » Përveç survejimeve, mund të bëhen përlogaritje të efekteve në biznes/ekonomi, të masave/ndërhyrjeve të realizuara që kanë dalë si propozime nga puna e KI.
- » Përmes analizave të detajuara të ndryshimeve rregullatore dhe impaktit të tyre në sektorin privat.
- » Me numrin e rekomandimeve që merren parasysh nga institucionet qeveritare
- » Përmes ndjekjes së procesit të zbatimit të rekomandimeve
- » Përmes rritjes së promovimit të punës së KI dhe bërjen transparent të informacionit të akumuluar.

08


Eksperienca personale dhe profesionale me KI



8.1 Gjatë eksperiencës suaj me Këshillin e Investimeve, çfarë konsideroni si përfitimin tuaj më të madh nga ky angazhim?

43% e të anketuarve vlerësojnë “Avokimin publik” si përfitimin më të madh nga pjesëmarrja në KI.


Figurë 20. Cili mendoni se ka qenë përfitimi juaj kryesor nga bashkëpunimi me KI?



8.2 Gjatë eksperiencës suaj me Këshillin, cili ka qenë kontributi juaj kryesor?


Kontributi në debate dhe Dërgim komentesh janë përgjigjet e pjesës më të madhe të të anketuarve.

Figurë 21. Cili mendoni se ka qenë kontributi juaj kryesor në punën e KI?



09

Qëndrueshmëria e platformës së KI




Opsionet e qëndrueshmërisë në afatgjatë të formatit të Këshillit të Investimeve dhe të Sekretariatit

Të gjithë të intervistuarit e konsiderojnë Këshillin e Investimeve si **një platformë afatgjatë dialogu e me interes për biznesin, duke ofruar transparencë dhe balancim publik-privat.**

Mbi opsionet e qëndrueshmërisë së këtij formati në të ardhmen, 48% e të anketuarve janë në favor të vijimit me të njëjtin format, 42% të formatohet në institucion më vete dhe 10% shprehen në favor të pagesës së anëtarësimit në KI:

Figurë 22. Qëndrueshmëria e KI si platformë afatgjatë

Si mendoni se mund të sigurohet qëndrueshmëria e KI si platformë afatgjatë dialogu dhe me interes për biznesin?




10

Vijueshmëria e bashkëpunimit me KI/anëtarët e KI

Nga të gjithë të intervistuarit u shpreh gatishmëria e vijimit të bashkëpunimit dhe komunikimeve të vazhdueshme edhe përmes sugjerimeve të temave konkrete për tu trajtuar, përfshirjes së KI në aktivitete të tyre dhe ndarjen e materialeve me KI.

SHTOJCA 1

Pyetësi drejtuar anëtarëve e bashkëpunëtorëve të KI



Ju lutem përzgjidhni nga lista më poshtë, nëse jeni:

- Biznes
- Institucion Publik
- Dhomë Tregtie
- Shoqatë Biznesi
- Ekspert i lirë
- Institucion Edukues/Akademik
- Shoqëri Civile
- Përfaqësues i Medias
- Partner për zhvillim
- Donatorë/ Programe zhvillimi
- Përfaqësi Diplomatike

1. Formati & Organizimi i KI si një kanal efektiv dialogu

Si e vlerësoni formatin dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit të Investimeve?

Ju lutem pikëzoni në një shkallë nga 1 në 5, secilin nga opsionet e mëposhtme:

Anëtarësia e KI (Numër, Përbërje, Proporcioni publik- privat)

1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet "Duhet përmirësuar" në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

.....

.....

Si e vlerësoni Frekuencën e mbledhjeve të KI

1-Duhet ulur 2-Kënaqshëm 3-Shumë Mirë 4-Duhet përmirësuar 5-Njësoj siç është aktualisht

Nëse u përgjigjet "Duhet përmirësuar" në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

.....

.....

Axhenda /Tematikat e trajtuara nga KI (Përzgjedhja e temave, Votimi nga anëtarët, Miratimi i agjendës vjetore)

1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet "Duhet përmirësuar" në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

.....

.....

□ Metodologjia e punës

- A. Qasja nga poshtë-lart⁸
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- B. Konsultime aktesh ligjore, ligje e projektligje me palët e përfshira si biznes, qeveri, partnerë për zhvillim, ekspertë, shoqëri civile, akademikë etj.
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- C. Përfshirja e anëtarëve në grupet e punës, në finalizimin e analizave dhe rekomandimeve
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- D. Survejimet periodike
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- E. Koha e marrjes së njoftimeve dhe e dërgimit të materialeve për diskutim në mbledhjen e radhës së KI
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- F. Diskutimet teknike në fokus grupe përpara mbledhjeve të KI për validimin e gjetjeve dhe rekomandimeve
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- G. Diskutimet teknike nga anëtarët dhe të ftuarit gjatë mbledhjeve të KI.
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- H. Aspekti operacional i organizimit të mbledhjeve të KI (vendi, përkthimi, zhurmat, etj.)
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet "Duhet përmirësuar" në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

□ Cilësia e materialeve analitike

Qartësia/ Saktësia e të dhënave të paraqitura/ Gjatësia

1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet "Duhet përmirësuar", ju lutem komentoni

□ Prezantimi i materialeve analitike në mbledhjet e KI përmes PPT përmbledhëse

- A. A është e nevojshme të bëhet prezantimi i përmbledhjes së materialit analitik të përgatitur nga Sekretariati i KI, si bazë për mbështetjen e diskutimeve të strukturuar më pas, mes sektorit privat dhe atij publik?

□ Po □ Jo

8 Metoda e punës e KI I referohet marrjes së problematikave nga sektori privat, analizimi i tyre dhe trajtimi përmes gjetje e rekomandime në mbledhjet e KI.

- B. Nëse u përgjigjet Po në pyetjen e mësipërme, a mendoni se kjo përmbledhëse

- a. Duhet diskutuar më gjatë sesa realisht bëhet (rreth 10 min)
- b. Duhet të jete më e shkurtër
- c. Duhet të jetë më e qartë
- d. Duhet të jetë më e detajuar
- e. Duhet të jetë më pak e detajuar
- f. Tjetër

Nëse u përgjigjet Tjetër, më sipër ju lutem komentoni

□ Rekomandimet

- A. Cilësia
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- B. Përshtatshmëria
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- C. Koherenca
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- D. Llogaridhënia & Publikimi
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet "Duhet përmirësuar" në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

□ Avokimi i çështjeve të trajtuara /Ndjekja e diskutimeve

- A. Nxitja e përmbushjes së rekomandimeve me aktorë me influencë
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- B. Trajtimi i problematikave të trajtuara në KI edhe në takime të organizuara nga aktorë të tjerë (bashkëpunim)
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet "Duhet përmirësuar" në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

□ Procesi i raportimit tek Anëtarët e KI

- A. Përzgjedhja dhe njoftimi mbi ndryshimet në anëtarësi apo informacione të tjera organizative
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- B. Raportimi i progresit të rekomandimeve
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- C. Raporte vjetore
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- D. Buletinë informues periodikë
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet "Duhet përmirësuar" në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

□ Në këndvështrimin tuaj, ju lutem listoni (qarkoni) 3 pikat më të forta të KI:

- A. Tematikat e trajtuara në KI
- B. Metodologjia e votimit të temave nga anëtarët.
- C. Metodologjia e punës, ndjekja e çështjeve dhe insistimi në realizimin e objektivit;
- D. Vëmendja e aktorëve kryesorë të qeverisë përmes pranisë së përhershme të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë;
- E. Gjithëpërfshirja, angazhimi dhe tërheqja e vëmendjes së përfaqësuesve kryesorë të qeverisë, bizneseve e donatorëve.
- F. Puna aktive e Sekretariatit, analiza dhe puna studimore e përcjellë përmes materialeve të çdo mbledhjeje;
- G. Rekomandimet e aprovuara në KI
- H. Ndjekja sistematike e progresit të rekomandimeve;
- I. Ndermjetësimi me aktorët përgjegjës për të përshpejtuar përmbushjen e rekomandimeve
- J. Mbështetja e BERZH si një faktor i rëndësishëm paanshmërie, reputacional dhe serioziteti;
- K. Balancimi i duhur i përfaqësimit qeveri-biznes
- L. Transparenca përmes publikimit të të gjithë materialeve të prodhuara.
- M. Tjetër

2. Cilësia dhe niveli i përfaqësimit të partnerëve (Shoqata biznesi, biznese, institucione shtetërore, partnerë në zhvillim)

BIZNESI - Si e konsideroni përfshirjen e komunitetit të biznesit

- A. Numri i përfaqësuesve në anëtarësinë e KI
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- B. Përbërja e anëtarësisë së biznesit (nga pikpamja e përfaqësimit edhe në nivel sektorial e shtrirje gjeografike)
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm

- C. Përbërja e anëtarësisë nga pikëpamja gjinore
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- D. Kontributi i shoqatave të biznesit, në dialog mbi problematikat më të rëndësishme të anëtarëve të tyre
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet "Duhet përmirësuar" në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

QEVERIA - Si do e vlerësonit përfshirjen e agjencive / institucioneve qeveritare në KI

- A. Numri i përfaqësuesve në anëtarësinë e KI
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- B. Përbërja e anëtarësisë dhe niveli i përfaqësimit
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- C. Përbërja e anëtarësisë nga pikëpamja gjinore
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- D. Kontributi në dialog mbi problematikat më të rëndësishme të anëtarëve të tyre
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm
- E. Shpejtësia e reagimit për përmbushjen e rekomandimeve
1-Duhet përmirësuar 2-Mirë 3-Kënaqshëm 4-Shumë mirë 5-Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet "Duhet përmirësuar" në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

3. Vizibiliteti i KI

3.1 A mendoni se Këshilli i Investimeve është i njohur mjaftueshëm në nivel kombëtar nga komuniteti i biznesit?:

1-Po 2- Jo 3- Nuk e di 4- Ndoshta

Nëse jo, çfarë metodash mendoni se janë më efçente për tu adaptuar që të përmirësojmë vizibilitetin e punës së KI? Cilësoni maksimumi tre sipas gjykimit tuaj.

- 1.....
- 2.....
- 3.....

3.2 A mendoni se faqja e internetit e KI /profilet e KI në rrjetet sociale (FB/LN/ Twitter) japin informacion të mjaftueshëm dhe lehtësisht të aksesueshem

1-Po 2- Jo 3- Nuk e di 4- nuk i kam përdorur asnjëherë

3.3 Cilin informacion keni më me interes të lexoni online:

- A. Informacion të përgjithshëm mbi KI (struktura, anëtarësia, etj.)
- B. Lajmet (të rejtat më të fundit)
- C. Grupet e Punës/Fokus Grupe mbi gjetje/problematika/ndjekje rekomandimesh
- D. Notat Teknike
- E. Gjetjet e Vrojtimeve
- F. Përmbledhje të Treguesve Makro-ekonomikë
- G. Raporte Monitorimi mbi Rekomandimet
- H. Raporte Vjetore të Aktiviteteve të KI
- I. Tjetër (nëse dëshironi ndonjë informacion tjetër)

4. Ndikimi i KI në Klimën e Investimeve

4.1 A ka ndikuar KI në përmirësimin e dialogut për klimën e investimeve në Shqipëri?

PO JO

Nëse po, konkretisht në çfarë drejtimi:

- a) në nxitjen e institucioneve publike për reagim ndaj kërkesave të biznesit
- b) në nxitjen e institucioneve publike për reagim ndaj rekomandimeve të dhëna në KI
- c) në nivel politikash
- d) në kuadrin rregullator
- e) në kuadrin ligjor
- f) në përmirësimin e konsultimit
- g) në rritje ndërgjegjësimi
- h) në ndërhyrje fiskale
- i) në përmirësimin e transparencës

4.2 Në opinionin tuaj, sugjeroni si mund të matet më mirë influenca e punës së KI ndër vite dhe kontributi në përmirësimin e klimës së investimeve? (Psh transparencën, konsultimin, ndërgjegjësimin etj.)

5. Eksperiencia personale dhe profesionale me KI

5.1 Gjatë eksperiencës suaj me Këshillin e Investimeve, çfarë konsideroni si përfitimin tuaj më të madh nga ky angazhim?

- A. Informimin
- B. Advokimin publik
- C. Rrjetëzimin
- D. Ndarja e eksperiencave

5.2 Cili ka qënë inputi juaj kryesor në bashkëpunim me KI?

- A. Dërgim komentesh
- B. Plotësim ankete
- C. Shpërndajre e anketave për plotësim nga të tretë
- D. Kontribut në debate
- E. Ndërveprim në aktivitete të përbashkëta
- F. Advokim i punës së KI tek të tretë

6. Qëndrueshmëria e platformës së KI

- A e shikoni Këshillin e Investimeve si një platformë afatgjatë dialogu dhe me interes për biznesin?** PO JO

Komentoni

- Nëse PO, si mendoni se mund të sigurohet qëndrueshmëria e saj në afatgjatë:**

- Të vijojë me të njëjtin format
- Të konsiderojë pagesë anëtarësimi
- Të formatohet në një institucion në vete
- Tjetër

7. Vijueshmëria e bashkëpunimit tuaj me KI

- Si e shikoni në vazhdim bashkëpunimin tuaj me Sekretariatit dhe Këshillin e Investimeve? A do ishit të gatshëm:**

- të merrnit iniciativën që të orientonit Sekretariatit e KI për të ngritur një temë specifike për diskutim në KI? PO JO
- të përfshinist Sekretariatit e KI në mbledhje si psh pjesëmarrës në mbledhje bordi/pjesë e komiteteve tuaja/evente të orientuara mbi klimën e investimeve të organizua ra nga ju? PO JO
- të ndani me sekretariatit e KI, materiale analitike apo dokumentuese të problematikave të hasura nga ju, për shqyrtim në KI apo ndjekje të mëtejshme? PO JO

JU FALENDEROJMË !

**Komente nga anëtarë
e bashkëpunëtorë të
Këshillit të Investimeve**

SEKRETARIATI I KËSHILLIT TË INVESTIMEVE
SHQIPËRI



2022

